



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E SHITES
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHITE



Drejtoria për Arsim
Uprava za Obrazovanje/Department of Education

Nr. i Protokollit: 05/ 196

Data: 6. 6. 2018

Në bazë të nenit 5, shkronja b) të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, Ligjit mbi Edukimin Parashkollor Nr. 02/L-52 dhe Rregullores për Organizimin e Punës në Arsimin Parauniversitar, nr. 01/91, datë: 31. 3. 2017, neni 86, pika 86.2:

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT (DKA) SHPALL

K O N K U R S

**PËR REGJISTRIMIN E FËMIJËVE NË INSTITUCIONIN PARASHKOLLOR
“ALBIONA ASLLANI” PËR VITIN KALENDARIK 2018/2019**

Regjistrimi i fëmijëve në Institucionin Parashkollor “Albiona Asllani” në Shite do të bëhet duke u bazuar në Kriteret e Regjistrimit të përcaktuara nga Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) përmes Vendimit nr. 05/ 195, të datës 6. 6. 2018, i cili do t'i bashkëngjitet këtij konkursi.

Të interesuarit janë të obliguar që t'i nënshtrohen konkursit pa dallim edhe nëse kanë qenë fëmijët e tyre më parë të regjistruar apo regjistrohen për herë të parë në IP “Albiona Asllani”.

Në bazë të kapaciteteve të Institucionit Parashkollor “Albiona Asllani” dhe Udhëzimit Administrativ nr. 19/2016 (MASHT) për Përfshirjen e Fëmijëve në Institucione Parashkollore – Raporti edukatore-fëmijë, do të jetë sipas këtyre grup-moshave:

- a). 09 muaj - 2 vjeç (6 fëmijë)
- b). 2 - 3 vjeç (16 fëmijë)
- c). 3 - 4 vjeç (11 fëmijë)
- d). 4 - 5 vjeç (12 fëmijë)

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM:

- 1. Kontratat e prindërve që janë në marrëdhënie pune,
- 2. Certifikata e lindjes së fëmijës,
- 3. Libreza e imunitetit/ vaksinimit,
- 4. Dëshmia nga mjeku pediatër për gjendjen shëndetësore të fëmijës.

Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë nga data e shpalljes: **7. 6. 2018** deri **21. 6. 2018**. Dokumentet për të aplikuar merren në Institucionit Parashkollor “Albiona Asllani” dhe dorëzimi i tyre bëhet në të njëjtin institucion çdo ditë pune prej orës **9:00** deri në ora **15:00**. Dokumentet e pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim. Shpallja e rezultateve bëhet më **29 qershor 2018** në Institucionin Parashkollor “Albiona Asllani”, rruga “Emin Musliu”, nr. 9. 72000 – Shtime.

Të gjithë të pakënaqurit me rezultatet e regjistrimit mund të ushtrojnë ankesë në Institucionin Parashkollor “Albiona Asllani” dhe nëse sërish janë të pakënaqur me vendimin e institucionit në fjalë, atëherë mund të ushtrojnë ankesë në DKA, në afat prej 3 ditësh.

DKA nuk e shqyrton asnjë ankesë, nëse pala paraprakisht nuk ka përgjigje me shkrim në ankesën e ushtruar në komisionin e Institucionit Parashkollor “Albiona Asllani”.



Drejtori,
Mensur NEZIRI